



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.07.2024

Nr: 117

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT PËR  
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR  
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Sot më datë 23.07.2024, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 2086 Prot., datë 22.07.2024, me:

**Kërkues:** “Balli Kombëtar Demokrat”, me kryetar z. Artur Roshi.

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Balli Kombëtar Demokrat”, (PBKD) si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

**VËREJ:**

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, ka caktuar datën 4 Gusht 2024, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë.

Partia “Balli Kombëtar Demokrat”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Artur Roshi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 Gusht 2024.

Data: 23.07.2024 Nr: 117  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Balli Kombëtar Demokrat” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

Nga Partia “Balli Kombëtar Demokrat” është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 22.07.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Balli Kombëtar Demokrat”, me iniciale “PBKD”, me kryetar z. Artur Roshi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Balli Kombëtar Demokrat” me shkronja nistore “PBKD”, me adresë Rruga “Hysni Gerbolli”, pranë Kryqit të Kuq Shqiptar, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Artur Roshi, me adresë Rruga “Hysni Gerbolli”, Vilë Private Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Sinan Vrapi, me adresë Rruga “Don Bosko”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Enea Cenko, me Rruga “Hysni Gerbolli”, pranë Kryqit të Kuq Shqiptar, Tiranë
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Balli Kombëtar Demokrat”, respekton afatin kohor të parashikuar në vendimin nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga Partia “Balli Kombëtar Demokrat”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe vendimit nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

## VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Balli Kombëtar Demokrat”, me kryetar z. Artur Roshi, me shkronjat nistore “PBKD”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orë nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**